



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.1.2022

Nr: 3

V E N D I M

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT  
ZGJEDHOR E TË ASGJËSIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR HAPJEN E KUTIVE TË  
VOTIMIT DHE KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE TË PËRDORURA NË  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenit 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S :

1. Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, të hapen dhe dokumentacioni zgjedhor të administrohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.
2. Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore në të cilat janë evidentuar indiciet për kallëzimet penale të bëra pas verifikimit paszgjedhore dhe ato për të cilat është vendosur sekuestro nga organet kompetente nuk hapen dhe sistemohen në një vend të posaçëm në mjediset e magazinës.
3. Fletët e votimit të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 dhe fletët e votimit të printuara nga pajisja elektronike e votimit dhe numërimit (PEVN) të asgjësohen me mënyrën e riciklimit.
4. Procedura për asgjësimin nëpërmjet riciklimit, do t’i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ngre:



Data: 22.1.2022

Nr. 3

“Për miratimin e mënyrës së administrimit të dokumentacionit zgjedhor, asgjësimin të fletëve të votimit dhe të shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”

- a) grupin e punës përgjegjës për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore dhe përcakton kriteret teknike të realizimit të procesit;
  - b) grupin e punës për fshirjen e të dhënave elektronike të pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit, i cili në fund të procedurës dorëzon procesverbalin ku konfirmon fshirjen e të dhënave elektronike dhe shkatërrimin e materialeve fizike sipas hapave të përcaktuara në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Grupi i punës i ngritur sipas shkronjës “a”, të pikës 5, të këtij vendimi, bën administrimin dhe evidentimin e:
- a) dokumentacionit zgjedhor të përcaktuar në nenin 178, pika 6, të Kodit Zgjedhor, i cili do t'i dërgohet Arkivit Qendror të Shtetit;
  - b) materialeve që mund të ripërdoren në zgjedhje të ardhshme;
  - c) fletëve të votimit në kutitë e fletëve të votimit, fletëve të votimit të printuara nga pajisja elektronike e votimit dhe numërimit (PEVN) dhe çdo dokument që nuk klasifikohet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.
7. Në përfundim të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, për secilën zonë të administrimit zgjedhor, personi i ngarkuar plotëson procesverbalin sipas modelit të Lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe në një dokument të veçantë evidenton listën me llojin dhe sasinë e materialeve që mund të ripërdoren.
8. Në përfundim të procesit të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, grupi i punës harton një raport dhe ia paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
9. Të dhënat biometrike të pajisjeve të identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe dokumentet e printuara nga pajisjet PEI me të dhëna sensitive të zgjedhësve do të asgjësohen në përputhje me udhëzimet e posaçme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 22.1.2022

Nr. 3

“Për miratimin e mënyrës së administrimit të dokumentacionit zgjedhor, asgjësimit të fletëve të votimit dhe të shpenzimeve buxhetore për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



### DREJTORIA E KOMISIONEVE DHE MATERIALEVE ZGJEDHORE SEKTORI I MJETEVE DHE MATERIALEVE ZGJEDHORE

#### LIDHJA 1

#### Procesverbal

#### Për:

Seleksionimin e dokumentacionit të gjetur brenda kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit të KZAZ-së për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

#### Baza Ligjore:

Neni 178/6 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas hapjes së kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit të KZAZ-së nr. \_\_\_\_\_, u gjet dhe u përzgjedh për t’u dërguar në Arkivin Qendror të Shtetit, dokumentacioni si më poshtë :

<b>QARKU:</b> _____	<b>ZAZ:</b> _____	<b>NUMRI I QENDRAVE TË VOTIMIT:</b> _____
------------------------	----------------------	--

#### Dokumentacion :

Nr.	Nr. i QV-së	Lista e Zgjedhësve	Regjistri i posaçëm	Libri i protokollit KQV-së	Procesverbal PV-KQV-07	Procesverbal PV-KQV-08
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						
11.						
12.						
13.						
14.						
15.						

<b>Punonjësi që administron dokumentacionin:</b> <b>Emër /Mbiemër:</b> _____ <b>Firma:</b> _____	<b>Sektori i Mjeteve dhe Materialeve Zgjedhore:</b> _____ (Emër,Mbiemër,Firmë)
--	--

**RREGULLA PROCEDURIALE PËR SHKATËRRIMIN E MATERIALEVE  
ELEKTRONIKE DHE FIZIKE PËR PAJISJET ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE  
NUMERIMIT (PEVN) DHE KAMERAT E VËZHGIMIT TË PËRDORURA NË  
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Hapat që do ndiqen për shkatërrimin e materialeve elektronike dhe fletëve të votimit për PEVN:

1. Çdo pajisje PEVN do të kthehet në gjendje fabrike duke ndjekur procedurën e reset të pajisjeve elektronike me sistem operimi android.
2. Të gjitha memoriet USB të prodhuara gjatë zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, do t'u fshihet informacion në mënyrë të përhershme nëpërmjet procesit të formatimit.
3. Serverit i cili mban rezultatet e votimit elektronik për ZAZ nr. 40, do t'i fshihen të dhënat e bazës së të dhënave në mënyrë të pakthyeshme duke përdorur mjetet e ofruara nga baza e të dhënave.
4. Fletët e votimit të cilat gjenden brenda kutive të votimit elektronik, do të asgjësohen me djegie dhe kutitë do të kthehen përsëri në magazinën e pajisjeve të votimit elektronik.

I gjithë procesi i shkatërrimit të të dhënave elektronike dhe fizike do të monitorohet nga minimumi 3 (tre) punonjës të caktuar në grup pune për këtë qëllim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.